

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 2487 Rep.

Nr. 730 Kol.

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot, me daten 25/3/2007 ne zyren e Noterise Tirane, perpara meje **Noteres Mimoza Shehu** u paraqiten personalisht te interesuarit si me poshte me cilesine e shitesit dhe blesesit te cilet ne baze te nenit 705 e vijues te K.Civil si dhe te Ligjit "Per shoqerite tregtare" kerkuan redaktimin e kesaj kontrate si vijon:

**SHITESA: 1-Malo Mane**, i biri i Aqifit, dtl. 3.12.1953, lindur dhe banues ne Sarande, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga pasaporta me nr. Z. 0408959

**2-Nurie Mane**, e datelindjes 6.10.1958, lindur dhe banuese ne Sarande, madhore dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, identifikuar nga pasaporta me nr. GR 5189407

**3-Mersida Mane**, e datelindjes 03.02.1985, lindur dhe banuese ne Sarande, madhore dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, identifikuar nga pasaporta me nr. 2.0408806

DHE

**BLERESI: Bledar Mane**, i biri i Malos, dtl. 12.12.1980, lindur dhe banues ne Sarande, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga pasaporta me nr. Z. 0408885

**OBJEKT:** Transferimin e pjesshem te kuotave te shoqerise "MANE" shpk qe i perkasin Z.Malo Mane, Nurie Mane, Mersida Mane ne mbeshtetje te ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" neneve 62,63 dhe neneve te Statutit te shoqerise tregtare "MANE" shpk.

Sipas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur deri ne ditën e sotme te shoqerise "MANE" shpk, shoqeri kjo e regjistruar si person juridik me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane nr. 4974 date 17.6.1994

Ortaket e shoqerise "MANE" shpk zoteron :

Z.Malo Mane me 70 % te kuotave te kapitalit.

Zj.Nurie Mane me 10% te kuotave te kapitalit

Zj.Mersida Mane me 10% te kuotave te kapitalit

Z.Bledar Mane me 10% te kuotave te kapitalit

Ne mbeshtetje te Ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" nenit 62,63 dhe neneve perkaftes te Statutit te shoqerise tregtare "MANE" shpk shitesat dhe bleresi bien dakort midis tyre per shitjen e kuotave si me poshte vijon:

1) Shitjen e pjeseve te kapitalit te shoqerise me menyren si vijon:  
**Nurie Manes** qe zoteron 10% te ketyre kuotave, **te Malo Manes** qe zoteron 70% te kuotave dhe **te Mersida Manes** qe zoteron 10% te kuotave, **Z. Bledar Manes** kundrejt shumes 90.000 leke i cili nga ana e tij deklarlon se eshte dakort per blerjen e tyre.

Perfundimisht ortak dhe administrator i vetem i shoqerise do te mbetet Bledar Mane qe zoteron 100% te kuotave te kapitalit.


Nga ky moment ai merr persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga administrimi i kesaj shoqerie.

Kontrata si u lexua dhe u gjet sipas vullnetit te paleve nenshkruhet vullnetarisht ne prani te noteress nga shitesi dhe bleresi dhe une noterja legalizoj nenshkrimet sipas ligjit.

Kontrata u redaktua ne tre kopje me fuqi te barabarte secila, ku njera prej tyre arkivohet ne kete zyre noteriale.

**SHITESA**


**Malo Mane**



**Nurie Mane**



**Mersida Mane**



**BLERESI**

**Bledar Mane**

